



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja Nr. 28

Prishtinë, më 8.12.2015. në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Živković - kryetare, Saša Milosavljević, Agim Kikaj, Čerim Bajrami, Veton Berisha, Danush Ademi, Slavko Simić i Milka Vuletić,

Munguan: Agim Çeku - nënkryetari i parë, Mufera Sinik – nënkryetarja e dytë, Fisnik Ismaili dhe Rustem Berisha.

Në mbledhje morën pjesë: përfaqësues nga OSBE-ja Ardiana Gashi, përfaqësuesi i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit – Celal Iliaz.

Nga njësia për mbështetje të Komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu,

Mbledhjen e kryesoi **Jasmina Živković** – kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Raportim lidhur me zbatimin e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, konkretisht neni 11.**

I ftuar: Ministër i Administratës Publike z. Mahir Yagcilar

Sekretar i përgjithshëm. z. Fitim Sadiku

Jasmina Živkovi, kryetare e hapi mbledhjen, falënderoi dhe përshëndeti gatishmërinë e ministrit për raportim të implementimit të Ligjit për shërbyesit civil në Republikën e Kosovës, dhe theksoi se Ligji rregullon një problematikë të rëndësishme, punësimin e pjesëtarëve të komunitetit pakicë në organet e administratës publike. Në vazhdim, ajo informoi ministrin për aktivitetet e planifikuara, të cilat i ka ndërmarrë Komisioni dhe Grupi i punës për mbikëqyrje të implementimit të Ligjit, me qëllim të përmbledhjes së informacioneve zyrtare dhe të dhënave të nevojshme, mbi shkallën e implementimit të Ligjit, gjegjësisht nenit 11. – të drejtën e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, në përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil në organet e administratës publike qendrore dhe lokale. Ajo theksoi se deri më sot neni 11. i këtij ligji, nuk respektohet dhe zbatohet nga ana e institucioneve shtetërore, nen që rregullon kuotën minimale dhe maksimale, në bazë të 10% të posteve të rezervuara që i takojnë komuniteteve të cilët nuk janë shumicë në Kosovë. Për shkak të një gjendjeje të tillë, ajo ka kërkuar përgjigje në pyetjet, çka nënkuptohet me “përfaqësim të drejtë dhe proporcional të pjesëtarëve të komunitetit pakicë në rastin e punësimit” dhe cilat janë arsyet e mosrespektimit të këtyre parimeve ligjore nga institucionet shtetërore. Ajo vazhdoi dhe tha: se këto të dhëna nuk pasqyrojnë gjendjen faktike në teren; se komuniteti serb në këtë rast nuk është i privilegjuar dhe se nuk duhet ndarë komunitetet në bazë të përkatësisë kombëtare në procesin e punësimit.

Veton Berisha, në bazë të vendimit të Komisionit, i inkorporuar në Planin e punës për vitin 2015, është formuar Grupi i punës për mbikëqyrjen e Ligjit për shërbyesit civil në Republikën e Kosovës, dhe me këtë rast është identifikuar neni 11. i këtij Ligji si lëndë e monitorimit, me qëllim të përcaktimit të shkallës së implementimit praktik të këtij neni, në rastin e komuniteteve të cilët nuk janë shumicë. Ai theksoi se, sipas statistikave, nuk ka objektivitet në rastin e punësimit, në krahasim me komunitetin, serb, turk e boshnjak, të cilët janë në pozitë më të mirë. Ai vazhdoi: se pragu prej 10% vlen për administratën publike si tërësi dhe jo për secilin institucion veç e veç; se në shumë institucione përfaqësimi i komunitetit egjiptas është më i ultë dhe nuk është në proporcion me përbërjen reale të popullsisë; se nuk mund të thuhet se në këtë rast mund të qëndroi shprehja “përfaqësim të drejtë dhe proporcional”; se ky trend i përfaqësimit të pamjaftueshëm është shqetësues dhe nuk mund të rregullohet me procesin e punësimit.

Konsideron se një gjendje e tillë paraqet shkelje të legjislacionit përkatës në fuqi dhe shkelje e parimit të “përfaqësimit të drejtë dhe proporcional” të komunitetit egjiptas, ashkali e rom në rastin e punësimit në administratën publike; se Ministria e administratës publike është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe implementimin e Rregullores, me të cilën rregullohet procedura për përfaqësimin të drejtë dhe proporcional të komuniteteve në rastin e punësimit, dhe përgjegjëse për raportimin e punësimit të komuniteteve në nivelin qendror e lokal; se lirisht mund të konstatohet se kjo shkallë e ultë e zbatimit nuk mund t'i mvishet joinformimit të institucioneve për obligimet e saja ligjore, sepse ato veç janë të informuara me dispozitat kryesore të Ligjit për shërbyesit civil dhe Rregullores, në lidhje me kuotat dhe formatin e konkursit; se një gjendje e tillë është shqetësuese dhe duhet të ndryshohet; se problemi nuk qëndron se ku duhet të intervenohet te ligji, por implementimi i ligjit është bazuar në vullnet

politik dhe jo në gjendjen reale; se qëllimi i kësaj mbledhje është të ndërmerret një iniciativë për eliminimin e kësaj gjendjeje dhe gjetjen e zgjidhjes së drejt dhe të barabartë për të gjitha komunitetet, duke mos favorizuar asnjërin.

Danush Ademi, tha se neni 11. i Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës përcakton dispozitat ligjore për punësimin e komunitetit pakicë në administratën publike dhe në bazë të informatave zyrtare, të cilat i ka ofruar Ministria e administratës publike rreth përfaqësimit të komunitetit joshqiptar në shërbimet e administratës publike të nivelit qendror e lokal, reflekton se pjesëtarët e komunitetit Rom, Ashkali e Egjiptas janë të përfaqësuar në shkallë të pamjaftueshme. Ai shtoi: se një numër i vogël i institucioneve ka mbajtur evidencë të kandidatëve, se cilit komunitet i takojnë dhe është prezent dukuria e identitetit të rremë, gjegjësisht prezantimit të rremë; se të gjitha institucionet janë të obliguara t'i përmbledhin të dhënat e kandidatëve që aplikojnë për punë, cilit komunitet i takojnë, me qëllim monitorimi dhe raportimi, por një përmbledhje e tillë nuk ka qenë e mundur të bëhet; se në shumicën e komunave pjesëtarët e këtij komuniteti nuk janë të punësuar në asnjë vend pune të administratës publike, madje as në ato komuna ku pjesëtarët e këtij komuniteti janë prezent në një numër relativisht të madh, dhe janë të punësuar kryesisht pjesëtarët e komunitetit shumicë; se është e nevojshme të krijohen programe që do ta mbështesnin punësimin dhe do ta avancojnë pozitën e komuniteteve, që janë të përfaqësuara në shkallë të pamjaftueshme, siç është rasti me komunitetin Rom, Ashkali e Egjiptas, dhe nëse Ministria e administratës publike nuk i përmbush pritjet e tyre, atëherë do t'i drejtohen gjykatës.

Ćerim Bajrami tha se, në bazë të Ligjit për shërbyesit civil, të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtën e përfaqësimit të drejtë dhe proporcional në shërbimet e administratës publike të nivelit qendror e lokal, por pjesëtarët e këtyre komuniteteve edhe më tutje janë të përfaqësuar në shkallë të pamjaftueshme, si në nivelin qendror, poashtu edhe në atë lokal. Në vazhdim ai shtoi: se gjatë mbledhjeve dhe debateve publike kanë dalë me përfundim se neni 11. është kontestues, me të cilin definohet që 10% e vendeve të rezervuara ju takojnë komuniteteve, por nuk përcakton që në këtë përqindje 10% të jenë të përfaqësuar pjesëtarët e të gjitha komuniteteve, dhe shtroi pyetjen – pse të mos tejkalohet kjo kuotë; se kjo çështje ligjore duhet të rregullohet, posaçërisht dukuria e identitetit të rremë, gjegjësisht prezantimit të rremë gjatë punësimit, siç është rasti në Ministrinë për forcën e sigurisë së Kosovës; se Grupi i punës, që monitoron zbatimin e rregullatave ligjore, më herët i ka dërguar pyetësorin ministrisë së linjës, me të cilin janë kërkuar të dhënat statistikore e të punësuarve, sipas përkatësisë kombëtare, siç është përcaktuar me nenet 8. 9. e 10. të Rregullores, se këto nuk janë të dhëna konfidenciale dhe mund të kenë qasje, dhe se në të ardhmen nuk do të zmbropsen nga një qëllim i tillë.

Ai theksoi: se Ministria e administratës publike nuk ka arritur të ofroi informacionet e kërkuara për pozitat e larta të funksionarëve, dhe për këtë arsye nuk ka qenë i mundur vlerësimi i gjendjes dhe numrit të pjesëtarëve të komuniteteve; që grupi ndërmintor ka formuar Grupin e punës që është marrë me këtë çështje, me qëllim të gjetjes së zgjidhjes më të mirë, por grupi ndërmintor asnjëherë nuk ka përpiluar asnjë raport për statistikat.

Në fund ai tha se monitorimi i Ligjit për shërbyesit civil, që ka filluar në vitin e kaluar nga Komisioni i tyre, do të vazhdoi edhe në këtë vit, kur edhe do të kryhet mbikëqyrja, me përpilimin e Raportit, i cili së bashku me të gjeturat e rekomandimet do t'i adresohet Kuvendit, për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Mahir Yagsilar –ministër i administratës publike tha se ka dëgjuar me kujdes të gjitha shqetësimet për nenin 11. të Ligjit për shërbyesit civil, i cili rregullon përfaqësimin procentual e të punësuarve në administratën publike nga radhët e komuniteteve pakicë, dhe në këtë kontekst, tha se e ka për obligim dhe përgjegjësi të informojë deputetët për nevojën e ndryshimit dhe plotësimit të këtij neni. Ai shtoi që Ligji për shërbyesit civil përcakton që së paku 10% e vendeve të punës t'i takojnë pjesëtarëve të komuniteteve, në shërbimet e organeve shtetërore, në nivelin qendror dhe lokal të administratës publike, dhe ky obligim, në bazë të ligjit, nuk është implementuar, posaçërisht për komunitetin Rom, Ashkali e Egjiptas. Ai u ka bërë thirrje anëtarëve të Komisionit të kyçen në aktivitetet, për ndryshimin e plotësimin e këtij ligji.

Poashtu ai theksoi se është e rëndësishme që ministria të ndërmerr hapa konkret në formimin e një mekanizmi mbrojtës, të krijojë një sistem elektronik të menaxhimit të resurseve humane, të dhëna elektronike që do të ofronin të dhënat e vërteta për të punësuarit, që janë të nevojshëm. Në vazhdim tha se Ministria nuk ka evidentuar të dhëna statistikore për kandidatët dhe nevojitet angazhim më i madh në zgjidhjen e çështjeve kyçe, por për të gjitha këto ndryshime do të votohet në parlament.

Mbledhja përfundoi në 12:30.

Njësia për mbështetje të Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Jasmina Živković